



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:256084
Datë: 29.04.2024
Numri i dokumentit: 05634384

A.C.nr.8297/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Bujar Muzaqi, kryetar i kolegjit, Enes Mehmeti dhe Hysni Bardheci, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit S.E., nga Komuna Ferizaj, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson A.P., avokat me seli në Komuna Prishtinë, me autorizim, kundër të paditurës Dogana e Kosovës, “Bulevardi Bill Klinton”, Komuna Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Xhafer Krasniqi, përfaqësues i të paditurës, në çështjen kontestimore për anulimin e vendimit dhe kompensimin e pagave, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, të parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.905/09 datë 25.05.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 18.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e paditësit S.E., nga Komuna Ferizaj, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.905/09 datë 25.05.2021, **VËRTETOHET.**

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, C.nr.905/09 datë 25.05.2021, ndër të tjera ka vendosur si vijon:

“... I. REFUZOHET NË TËRËSI SI E PABAZUAR, kërkesëpadia e paditësit S.E., nga Ferizaj, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Dogana e Kosovës, Bulevardi “Bill Klinton”, Prishtinë, që të ANULOJË Vendimin e të paditurës për Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës Nr.362/17.04.2009 si i kundërligjshëm, të Detyrohet e paditura që paditësin të kthejë në vendin e tij të punës Oficer Doganor. Te

detyrohet e paditura që në emër të pagave neto për periudhën 17.04.2009 deri me datë 30.10.2020, t'ia paguaj pagat në shumë prej 56,617.00 euro, për Kontributet pensionale t'ia paguaj paditësit shumën prej 6.622 euro, Tatimin në pagë për paditësin t'ia paguaj shumën prej 6.291 euro. Prej datës 30.10.2020 e deri në kthimin e paditësit në vendin e punës si oficer doganor ti paguaj në emër të pagës mujore shumën prej 672.58 euro., të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% nga dita e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale...”.

Kundër aktgjykimit të ankimuar i autorizuari i të paditurës brenda afatit ligjor me datë 26.01.2017, ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet e bazuar ankesa e të autorizuarit të të paditurës ndërsa dhe të hedhet poshtë Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren – dega në Dragash.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e të paditurës është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndesh rezulton se paditësi S.E., ka parashtruar në gjykatën e shkallës së parë me datë 04.12.2018, kundër të paditurës Dogana e Kosovës, “Bulevardi Bill Klinton”, Komuna Prishtinë, padi për kontest pune.

E paditura ka paraqitë në Gjykatë përgjigje në padi me datë 03.04.2019, ku ndër të tjera në përgjigje në padi ka deklaruar se “...konsideroj se padia dhe kërkesëpafia janë të parashkruara dhe si të tillë gjykata duhet refuzuar...”.

Gjykata e shkallës së parë, e ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor dhe pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor me datë 25.05.2021, dhe administrimit të provave, e ka refuzuar si të pa bazuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit.

Gjykata e shkallës së parë aktgjykimin e atakuar e ka arsyetuar ndër të tjera si vijon “...Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë provat me të cilat konstatohen faktet e tilla, ndërsa me dispozitat e nenit 319.1 të LPK , parashihet se secila palë ndërgjyqës ka për detyrë ti provoi faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta. Ne rastin konkret paditësi, me provat e administruara gjate shqyrtimit kryesor nuk arriti të argumenton nëse vendimet e të paditurës kanë qenë të pabazuara, padia e paditësit nuk ka bazë ligjore. Hudhja e aktakuzës dhe Aktvendimi për pushim të procedurës penale nuk mund të jenë të lidhur në pikëpamje të bazës juridike për anulimin e vendimeve të nxjerra në procedure disiplinore ndaj paditësit. Gjithashtu ekspertiza financiare nga eksperti nuk paraqet bazë juridike për kërkesëpadinë e paditësit, sepse nga ajo ekspertizë vetëm është përllogaritur shuma

sa kishte me realizuar paditësi sikur të ishte në marrëdhënie pune, e nuk paraqet bazë juridike për të drejtën e kërkuar nga ana e paditësit. Procedura disiplinore është zhvilluar konform rregullave ligjore të standardeve profesionale të paditurës, dhe me asnjë provë të vetme nuk është vërtetuar se vendimet e të paditurës janë të kundërligjshme dhe të pabazuara...”.

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe nuk ka shkelje nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore, për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Pretendimi ankimor i paditësit se aktgjykimi i atakuar është marrë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, nga se sipas të paditurës dispozitivi i aktgjykimit është i pa kuptimtë dhe në kundërshtim me arsyet e dhëna, për Gjykatën e Apelit është pretendim i pathemeltë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i Aktgjykimit të atakuar është mjaft i kjashtë, e në përputhje të plotë me arsyet e Aktgjykimit, Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për refuzimin e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar, në përputhje të plotë me përmbajtjen e kërkuar me dispozitat e nenit 160 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore.

Lidhur me pretendimet e paditësit, se duke u bazuar në Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, departamenti i krimeve të rënda, P.nr.319/2009 datë 18.01.2018, me të cilin Aktvendim, paditësi është liruar nga akuza, janë pretendime të pa bazuara, pasi që lirimi nga përgjegjësia penale, nuk nënkupton domosdoshmërisht edhe lirimin nga procedura disiplinore, pasi shkeljet disiplinore nuk duhet të jenë patjetër të karakterit penal, por mjaftojnë që shkeljet e tilla të paraqesin shkelje të detyrave të punës, e që janë arsye e mjaftueshme për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, siç është në rastin konkret, pa u vërtetua përgjegjësia penale.

Në nenin 70 par.1.4.1 të ligjit nr. 03/l-212 të Punës, ndër të tjera thuhet se “... *punëdhënësi mund t’ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit në periudhën e kërkuar të paralajmërimit të ndërprerjes në : ... rastet e rënda të sjelljes së keqe të punonjësit...”.*

Edhe dëshmitari G.S., në seancën e datës 11.03.2021, të mbajtur në Gjykatën Themelore në Prishtinë ndër të tjera ka deklaruar se “...*gjatë kryerjes së detyrave ka qenë i inkriminuar në veprime të kundërligjshme të cilat veprime janë të pandershme*

dhe jo profesionale pasi që nuk ka zbatu aktet përkatëse rregulloret dhe udhëzimet per shkak se te gjithë zyrtarët duhet ti përmbahen ligjeve dhe te veprojnë ne përputhshmëri te plote me aktet ligjore...”.

Pretendimi ankimor i paditësit se të gjithë punëtorët tjerë të cilët janë larguar nga puna, janë kthyer në punë për veç paditësit, këto pretendime janë të pa bazuara pasi që në shkresat e lëndës nuk ka asnjë provë se cilët punëtorë tjerë janë kthyer në punë për veç paditësit, po as të dhëna tjera nuk ka në ankesë.

Në nenin 7 paragrafi 1 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore në mënyrë decisive thuhet se : *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”.*

Pretendimi ankimor i paditësit se Gjykata fare nuk është lëshuar në vlerësimin e vendimeve të të paditurës për suspendimin dhe më vonë largimin e paditësit nga puna, ky pretendim është i pa bazuar pasi që në Aktgjykimin C.nr.905/09 datë 25.05.2021 ndër të tjera thuhet se *“...Procedura disiplinore është zhvilluar konform rregullave ligjore të standardeve profesionale të të paditurës, dhe me asnjë provë të vetme nuk është vërtetuar se vendimet e të paditurës janë të kundërligjshme dhe të pa bazuara”.*

Gjykata e Apelit vlerëson se sa i përket pretendimit ankimor të palës paditëse se kemi të bëjmë me aplikim të gabuar të drejtës materiale nuk ka ndonjë pretendim konkret në të cilën është thirrur pala ankuese në ankesë, ndërsa nuk ka shkelje për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore, por Gjykata e Apelit nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 195.1 pika d), lidhur me nenin 200, të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
A.C.nr.8297/21 datë 18.04.2024

Kryetari i kolegjit – gjyqtari,
Bujar Muzaqi